



Republika e Shqipërisë
Ujësjetës Kanalizime Kamëz sh.a
Drejtoria Ekonomike
Sektori i Financës dhe Kontabilitetit

UKK sh.a.

Ujësjetës Kanalizime Kamëz

Pasqyrat Financiare për periudhën kontabël të mbyllur më

31 Dhjetor 2019



Republika e Shqipërisë
Ujësjetillës Kanalizime Kamëz sh.a
Drejtoria Ekonomike
Sektori i Financës dhe Kontabilitetit

PËRMBAJTJA

FAQE

PASQYRAT FINANCIARE :

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E FLUKSEVE TË MJETEVE MONETARE	7
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE TË VITI	8-21

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
AKTIVE			
Aktivët afatgjatë			
Aktivët afatgjatë materiale	4	333,851,088	0
Aktive afatgjatë jo materiale		0	0
Tituj pjesmarjeje		0	0
Parapagime për aktive të tjera afatgjatë		0	0
Totali i aktiveve afatgjatë		333,851,088	0
Aktivët afatshkurtra			
Inventarë		0	0
Llogaritë e arkëtueshme	5	225,458,133	0
Aktive tatimore të shtyra		0	0
Llogari të arkëtueshme të tjera		0	0
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra		0	0
Mjetet monetare në arkë e në bankë		0	0
Totali i aktiveve afatshkurtra		225,458,133	0
Totali i aktiveve		559,309,221	0
KAPITALI			
Kapitali aksionar	6	289,024,326	0
Rezerva të tjera		0	0
Rezerva rivleresimi	4	17,851,570	0
Fitimi i ushtrimit	6	5,657,177	0
Totali i kapitalit		312,533,073	0
DETYRIMET			
Detyrime afatgjatë			
Totali i detyrimeve afatgjatë		0	0
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra		0	0
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	7	242,662,231	0
Detyrime ndaj personelit	9	815,078	0
Detyrime tatimore	9	3,298,839	0
Totali i detyrimeve afatshkurtra		246,776,148	0
Totali i detyrimeve		246,776,148	0
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		559,309,221	0

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nr.1-18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Z. Shpetim Leskaj
 Drejtor i
 Përgjithshëm



Z. Aleks Palnikaj
 Drejtor Ekonomik

Pasqyra e Fitim ose Humbjes dhe të të ardhurave gjithpërfshirëse
 Për vitin mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	10	10,858,308	0
Të ardhura të tjera		0	0
Total të ardhura		10,858,308	0
Lende e pare dhe materiale te konsumueshme	11	(1,449,792)	0
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	4 & 14	(1,305,883)	0
Rënia në vlerë e emrit të mirë		0	0
Shpenzime zhvlerësimi konsum i inventarit të imët		0	0
Shpenzimet te tjera	12	(270,000)	0
Rimarrje/(Shpenzime) provizione llogari të arkëtushme		0	0
Shpenzime personeli	13	(1,129,484)	0
Total shpenzime		(6,703,149)	0
Të ardhurat financiare		0	0
Shpenzimet financiare		0	0
Fitimi/humbja para tatimit		6,703,149	0
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(1,045,972)	0
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	15	(1,045,972)	0
		-	0
Fitimi/humbja e vitit	6	5,657,177	0
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	0
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	0
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin	6	5,657,177	0

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nr.1-18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Z. Shpetim Leskaj
Drejtor i
Përgjithshëm



Z. Aleks Palnikaj
Drejtor Ekonomik

Ujësjellës Kanalizime Kamez sh.a

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital me 31 dhjetor 2019

	Kapitali aksionar	Rezerva Rivlerësimi	Rezerva Lajgore	Rezerva të tjera	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
pozicioni financiar më 01 Janar 2019							
Kapitali i regjistruar nga ndarja e "U.K.T" sh.a.	289,024,000						289,024,000
Krijimi i rezervës ligjore							0
Fitimi i vitit					5,657,177		5,657,177
Rezerva nga rivlerësimi AAM		17,851,570					17,851,570
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	289,024,000	17,851,570	0	0	5,657,177		312,533,073

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nr. 1-18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Z. Shpetim Leskaj
Drejtor i Përgjithshëm

Z. Aleks Palmikaj
Drejtor, Ekonomik

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

	Periudha 31 dhjetor 2019	Periudha 31 dhjetor 2018
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:		
Te arketuara nga te drejtat e arketueshme		
Te paguara per detyrime e pagueshme dhe detyrimet per punonjesit		
Pagesa te tjera		
Te tjera (pershkruaj)		
Mjete monetare te gjeneruara nga aktiviteti i shfrytezimit		
Interes i paguar		
Tatim fitimi i paguar		
Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit	0	0
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit		
Pagesa per blerjen e aktiveve afatgjata materiale		
Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		
Para te perdorura per blerjen e filjaleve		
Para te arketuara nga shitja e filjaleve		
Pagesa per blerjen e investimeve te tjera		
Arketime nga shitja e investimeve te tjera		
Dividende te arketuar		
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit	0	0
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit		
Arketime nga emetimi i kapitalit te nenshkruar		
Arketime nga emetimi i aksioneve te perdorura si kolateral		
Hua te arketuara		
Pagesa e huave		
Pagese e detyrimeve te qirase financiare		
Dividende te paguar		
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit	0	0
Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to	0	0
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim		
Efkti i luhatjeve te kurset te kembimit te mjetet monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund	0	0

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nr.1-18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Z. Shpetim Leskaj
Drejtor i
Përgjithshëm



Z. Aleks Palnikaj
Drejtor Ekonomik

1. Informacion i përgjithshëm

1.1 Informacion mbi Shoqërinë

Shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Kamëz (UKK) Sh.a. është regjistruar më datën 13.11.2017 pranë QKB-së me NIPT L723200034A, sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë (UKT) sh.a., si rezultat i ndarjes së kësaj shoqërie.

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Bulevardi Blu, Kamëz Tiranë. Shoqëria është subjekti i regjistruar në TVSH.

Kapitali i Shoqërisë zotërohet 100% nga aksioneri i vetëm, Bashkia Kamëz. Kapitali përbëhet nga 289,024 aksione, me vlerë nominale Lekë 1000/aksion, me vlerë totale për 289,024,000 Lekë.

Administrator i shoqërisë është emëruar Z.Shpëtim Leskaj, me mandat 3 vjeçar, me afat nga 01/10/2019 -01/10/2022. Ndërkaq Shoqëria drejtohet dhe mbikqyret nga Këshilli i Administrimit, që përbëhet nga anëtarët: z. Hasan Bara; z. Hajredin Murgu dhe Shpëtim Leskaj me afat emërimi nga 01/10/2019 -01/10/2022.

Shoqëria operon në aktivitetin e furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe shitjes së tij. Mirëmbajtje e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm; prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve, shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe shitja e tij, mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impiantëve të pastrimit të tyre.

Marrëveshja e Ndarjes

Në bazë të Marrëveshjes së Ndarjes në datën 27.09.2017 u vendos që UKT Sh.a. të ndahet dhe shoqëritë pritëse që u krijuan rishtazi ishin si më poshtë:

1. Shoqëria Ujësjetllësi-Kanalizime Bashkia Tiranë sh.a.,
2. Shoqëria Ujësjetllësi-Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a.,
3. Shoqëria Ujësjetllësi-Kanalizime Bashkia Vorë sh.a.

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë që ndahet do të merreshin përsipër nga shoqëritë pritëse sipas zonës së juridikisionit të bashkive respektive dhe me të njëjtat kushte sikur zbatohen ende nga Shoqëria që ndahet.

Ndarja është realizuar në datën 20 nëntor 2017 sipas raportit të ndarjes, në bazë të bilancit të pa-audituar të shoqërisë në datën 31 dhjetor 2016. Raporti i ndarjes nga eksperti është lëshuar në datën 16 shkurt 2017.

Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a. nuk e ka pranuar vendimin e Asamblese së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë UKT Sh.a. "Per miratimin e Projekt marreveshjes dhe Raportit të ndarjes së aksionarëve Bashkia Vore dhe Kamez nga shoqeria Ujesjetlles Kanalizime Tirane sh.a." dhe ka hapur proces gjyqesor per pavlefshmerine e ketij vendimi. UKB Kamza nuk ka marre ne dorezim asetet dhe ato jane te pasqyruara ne bilancin e Ujesjetlles Kanalizime Tirane deri me date 31 Tetor 2019.

Në Pasqyrën e Ndarjes të Pozicionit Financiar të shoqërisë më 20 nëntor 2017 më poshtë është paraqitur ndarja e shoqërive pritëse datës 20 nëntor 2017.

Pasqyra e Ndarjes të Pozicionit Financiar të shoqërisë më 20 nëntor 2017 (në mijë Lekë)

	UKT Sh.a. 20 nëntor 2017	UKB Tirane	UKB Vore	UKB Kamëz
AKTIVE				
Aktivitet afatgjata				
Aktivitet afatgjata material	14,286,625	14,084,898	62,905	138,822
Aktive afatgjata jo material	717,064	717,064	-	-
Tituj pjesëmarrje	192,398	192,398	-	-
Parapagime për aktive të tjera afatgjata	12,691	12,691	-	-

Ujësjetllës Kanalizime Kamëz sh.a
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Totali i aktiveve afatgjata	15,208,778	15,007,051	62,905	138,822
Aktivet afatshkurtra				
Inventarë	499,570	499,570	-	-
Llogari të arkëtueshme tregtare	2,863,163	2,684,960	20,110	158,093
Aktive tatimore të shtyra	2,238	2,238	-	-
Llogari të arkëtueshme të tjera	136	136	-	-
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	19,260	19,260	-	-
Mjetet monetare në arkë e në bankë	100,646	100,646	-	-
Totali i aktiveve afatshkurtra	3,485,013	3,306,810	20,110	158,093
Totali i aktiveve	18,693,791	18,313,861	83,015	296,915
KAPITALI				
Kapitali aksionar	2,544,398	2,174,332	81,041	289,024
Rezerva nga rivleresimi	3,219,601	3,219,601	-	-
Rezerva ligjore	79,745	79,745	-	-
Rezerva statutore	3,681	3,681	-	-
Fitime të mbartura	1,877,667	1,877,667	-	-
Fitimi i ushtrimit	471,872	471,872	-	-
Totali i kapitalit	8,196,963	7,826,898	81,041	289,024
DETYRIMET				
Detyrime afatgjata				
Hua afatgjata	5,576,996	5,576,996	-	-
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	466,424	466,424	-	-
Totali i detyrimeve afatgjata	6,043,420	6,043,420	-	-
Detyrime afatshkurtra				
Hua afatshkurtra	1,750,755	1,750,755	-	-
Llogari të pagueshme tregtare	2,512,618	2,512,618	-	-
Detyrime ndaj personelit	37,610	37,610	-	-
Detyrime tatimore	13,261	13,261	-	-
Provizione	139,164	139,164	-	-
Diferenca me raportin e ndarjes UKT, Vore, Kamez	-	(9,865)	1,974	7,891
Totali i detyrimeve afatshkurtra	4,453,408	4,443,543	1,974	7,891
Totali i detyrimeve	10,496,828	10,486,963	1,974	7,891
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	18,693,791	18,313,861	83,015	296,915

Gjate vitit 2019 duke u bazuar në vendimin e Këshillit të Bashkisë Kamëz nr.18 date 19.09.2019 "Per miratimin e Marreveshjes për ndarjen e shoqërisë "Ujësjetllës Kanalizime Tiranë" sh.a dhe marrjen në dorëzim të shoqërisë "Ujësjetllës Kanalizime Kamëz" sh.a u realizua marrja në dorëzim e të drejtave dhe detyrimeve në zbatim të akteve të ndarjes së shoqërisë "Ujësjetllës Kanalizime Tiranë" sh.a.

Data 31.10.2019 është caktuar si datë për marrjen në dorëzim të aseteve, të drejtave dhe detyrimeve. Këta të drejta dhe detyrimeve janë pranuar dhe marrë në dorëzim sipas procesverbalit nr.Urdher 69/2/3 Prot. të datës 17.12.2019 pas ngritjes së grupeve të punës të paraqitur në urdhërin Nr.644 datë 20.11.2019 të Kryetarit të Bashkisë Kamëz dhe Urdhërit nr.69/1 datë 20.11.2019.

Procesi gjygesor per pavlefshmerine e vendimit e ndarjes eshte pezulluar gjate 2020.

1.2 Informacion mbi veprimtarinë

a. Informacion mbi produktet kryesore dhe shërbimet e UKK sha

UKK ofron shërbimet e mëposhtme:

- i) shpëNDARJEN E UJIT TË PIJSHËM
- ii) instalimin e matësve
- iii) instalimin e pikëlidhjeve me rrjetin
- iv) azhornimin e rrjetit
- v) largimin e ujrave të ndotura

Licensimi : Gjate 2020 janë bërë të gjitha dokumentat per marrjen e licensimit nga Erru.

2. Bazat e përgatitjes

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë dhe baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur në përputhje me Ligjin 25/2018 datë 10.05.2018 “Per kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, me datë efektive nga 01.01.2019 si dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të zbatueshme në Shqipëri (SKK). Në rastet kur SKK nuk parashikojnë çështje të veçanta, janë zbatuar parashikimet në Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme.

2.2 Vijimësia e aktivitetit

Drejtimi i shoqërisë ka kryer nje vleresim te aftesise se shoqërisë per te vazhduar aktivitetin ne vijimesi dhe eshte i bindur qe shoqëria ka burime per te vazhduar biznesin dhe aktivitetin ne te ardhmen. Gjithashtu drejtimi nuk eshte ne dijeni te ndonje pasigurie materiale edhe për shkak të situatës së Covid-2019, qe mund te sjelle dyshime te konsiderueshme mbi mundesine e shoqërisë per te vazhduar ne vijimesi. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojne te përgatiten ne baze te parimit te vijimesise.

2.3 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar (“Lek”), e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

2.4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të Shoqërisë dhe në njohjen dhe matjen e shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Shembuj të zbatimit të vlerësimeve kontabël janë:

- (a) vlerësimi i zhvlerësimeve për kërkesat e arkëtueshme dhe inventarëve;
- (b) vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale, përcaktimi i normave përkatëse të amortizimit dhe i zhvlerësimeve te aktiveve;
- (c) krijimi i provizioneve për shitjet me garanci ose për mbulimin e kostove që lidhen me procedurat gjyqësore në proces.

Në veçanti, informacioni mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet shpjeguese përkatëse të këtyre pasqyrave financiare.

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Eshtë i nevojshem gjykimi per përcaktimin e shumës së tatimit mbi fitimin aktual dhe atyre te shtyra. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar tatimor është i pasigurt. Shoqëria nje detyrimin ne rast te auditimit të pritur tatimor bazuar në vlerësimet se taksa shtesë do mund te lindin si detyrim. Nese tatimi perfundimtar do jete i ndryshëm nga shumat që ishin regjistruar fillimisht, diferencat do e ndikojë në vleren aktuale te aktiveve tatimore të shtyra dhe pasiveve në periudhën në të cilën një përcaktim i tillë është bërë.

3. Politikat Kontabël

Në përgatitjen e pasqyrave financiare janë zbatuar parimet kontabël që njihen si më të përshtatshme për të matur dhe paraqitur gjendjen financiare, rezultatit financiar dhe flukset e parasë mbi gjendjen e kontabilitetit rrjedhës (të drejtat dhe detyrimet e konstatuara). Matja fillestare e aktiveve dhe detyrimeve që plotësojnë kriterin e njohjes, bëhet me kosto historike, përveç rasteve kur SKK 1, kërkon matje fillestare mbi një bazë tjetër të tillë si vlera e drejtë. Vlerësimi i mëpasshëm i aktiveve dhe detyrimeve financiare bëhet me kosto të amortizuar minus ndonjë zhvlerësim të mundshëm, sikurse përcaktohet në SKK 3, ndërsa të aktivet dhe pasivet e tjera duhet ti referohemi rast pas rasti SKK-ve përkatëse.

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar për përgatitjen e pasqyrave financiare.

3.1. Instrumentat financiare

Një instrument financiar është çdo kontratë që krijon një aktiv financiar të një njësie ekonomike dhe një pasiv financiar ose instrument kapitali neto të një njësie ekonomike tjetër. Instrumentet financiare jo-derivative të Shoqërisë përbëhen nga paratë dhe ekuivalentët e tyre, të arkëtueshmet tregtare dhe të arkëtueshme të tjera, llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera, të arkëtueshme dhe të pagueshme nga njesite ekonomike pjesë e grupit, huamarrjet dhe huadheniet.

3.2. Aktivet financiare

Një njësi duhet të njohë një aktiv financiar ose një detyrim financiar vetëm kur njësia bëhet pjesë e kushteve kontraktuale të instrumentit. Kur një aktiv financiar ose një detyrim financiar njihet fillimisht, një njësi duhet ta masë atë me koston e transaksionit (duke përfshirë edhe çmimin e transaksionit) përveç rasteve kur marrëveshja përbën në thelb, një transaksion financiar. Nëse marrëveshja përbën një transaksion financiar, njësia duhet të masë aktivin financiar ose detyrimin financiar me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuara me normën e interesit të tregut për një instrument të ngjashëm borxhi.

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar minus humbjet nga zhvlerësimi. Në këto zë janë përfshirë kërkesa të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit, të cilat në njohjen fillestare janë vlerësuar me vlerën e paskontuar apo me koston e transaksionit. Pas njohjes fillestare, aktivet financiare me kosto të amortizuar maten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe janë subjekt i rënies në vlerë (zhvlerësimit). Fitimet dhe humbjet njihen në fitim ose humbje kur aktiviteti çregjistrohet, modifikohet ose zhvlerësohet. Aktivet financiare të Shoqërisë që maten me koston e amortizuar përbëhen kryesisht nga të drejta të arkëtueshme.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktiviteti financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit pjesa më e madhe e rreziqeve dhe e përfitimeve të pronësisë së aktivitetit financiar, janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivitetit financiar.

Në fund të çdo periudhe raportimi, një njësi duhet të vlerësojë nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktiviteti financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njësia duhet të njohë menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje.

3.3. Detyrimet financiare

Në këtë grup janë përfshirë detyrimet e pagueshme ndaj furnitoreve, ortakëve për dividendë, hua dhe interesa, punonjesve, administratës tatimore, kreditorëve të tjerë, etj. Në njohjen fillestare zerat e këtij grupi janë vlerësuar me kosto. Në fund të vitit detyrimet vlerësohen me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e llogaritjes së kostos së amortizuar të një aktivi financiar ose një detyrimi financiar (ose një grup aktivesh ose detyrimesh financiare) dhe e shpërndarjes së të ardhurave të interesit ose shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës përkatëse.

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë.

Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe rrjedhimisht flukset monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet një detyrim financiar i ri, me vlerën e drejtë, i bazuar në kushtet e modifikuara. Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca mes vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv jomonetar të transferuar apo detyrime të supozuara) njihet si fitim ose humbje.

Kompensimi

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur shoqëria ka të drejtë ligjore për të shlyer shumatat dhe ka për qëllim të shlyejë ato në baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

3.4. Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parësë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Shoqëria nuk disponon mjete monetare në datën raportuese.

3.5. Llogari të arkëtueshme dhe të pagueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen me vlerën e drejtë duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi.

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare që nuk kanë një normë interesi të deklaruar dhe janë të klasifikuara si aktive afatshkurtra ose detyrime afatshkurtra, maten fillimisht me shumën e paskontuar në përputhje me paragrafin 15(a) të SKK3. Në këto rast nuk zbatohet metoda e interesit efektiv. Në fund të çdo periudhe raportimi, një njësi duhet të vlerësojë nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit të ndonjë aktivi financiar që matet me kosto ose me kosto të amortizuar. Nëse ka një evidencë objektive të zhvlerësimit, njësi duhet të njohë menjëherë një humbje nga zhvlerësimi në fitim ose humbje. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parësë të skontuara me normën efektive të interesit.

3.6. Kapitali aksionar

Kapitali aksionar përbëhet nga aksione, të cilat njihen me vlerën nominale.

3.7. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga

përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime me metodën lineare mbi jetën e dobishme të aktivitetit për ndërtesat, kompjuterat, furniturat dhe pajisje, rrjeti ujësjelles dhe kanalizimeve dhe mjetet e transportit. Aktivitetet e marra me qera amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër midis periudhës së qiramarrjes dhe jetës së tyre të dobishme. Toka nuk amortizohet.

Baza e përlllogaritjes përfshin shumën fillestare të makinerive dhe pajisjeve dhe duke zbritur vlerën e rikuperueshme të aktivitetit. Vlerësimi i jetës së aktiveve është bërë duke parë nivelin e lartë të konsumimit dhe dëmtimet në asetet e UKK Sh.a. Normat e amortizimit të AAM të përdorura nga Shoqëria janë të ndryshme nga normat e amortizimit për qelime fiskale 5% dhe 20%, pasi shoqëria kryen llogaritjet bazuar në vitet e përdorimit të mbetura për secilin aktiv. Normat e përdorura për llogaritjen e amortizimit për periudhën Nentor -Dhjetor 2019, është e njëjta me ato të përcaktuara dhe pranuar nga komisioni i marrjes në dorëzim të aktiveve me datë 17 Dhjetor 2019. Aktivitetet në Proces nuk janë amortizuar.

iv. Rënia në vlerë

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuarat monetare të ardhshme janë zbritur për vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivitetin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera e mbartur e aktivitetit apo pjesa e burimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime. Zbritja në vlerë e aktiveve, përveç emrit të mirë, aplikohet sa herë që ngjarjet të cilat kanë ecur në këtë rënie të vlerës ndryshojnë.

v. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.8. Inventarët

Inventarët maten me më të voglën midis Kostos Historike dhe Vlerës Neto së Realizueshme. Vlera Neto e Realizueshme është e ardhura e parashikuara nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus kostot e parashikuara të shitjes. Kostot e inventarit janë përlllogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshin shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe e dërgimit të tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese. Shoqëria nuk disponon inventarë në datën raportuese.

3.9. Të ardhurat

Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse (rritjen e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese, që çojnë në rritjen e aktiveve ose pakësimin e pasiveve, si dhe që rrisin kapitalin e njësisë ekonomike raportuese, duke përjashtuar këtu ato flukse që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital. Të ardhurat përfshijnë vetëm hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga njësisë ekonomike për llogari të vet. Shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar nuk janë

përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto. Për këtë arsye ato nuk përfshihen në të ardhura.

Të ardhurat nga shitja

Te ardhurat nga shërbimet e furnizimit me uje të pijshëm dhe shërbimet e kanalizimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimit, bazuar në matjen që realizohet të konsumit. Të ardhurat nga shërbimet e miëmbajtjes dhe azhornimit, si dhe të shitjes së produkteve: të matësave, librezave të ujit etj, njihen në momentin e realizimit të tyre. Përgjithësisht, të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose që do të arkëtohet. Në rastin kur një pagesë e shtyrë ka një ndikim të rëndësishëm në llogaritjen e vlerës së drejtë, do të llogaritet duke skontuar pagesat e ardhshme. Vlerësimi i arkëtimit të llogarive të arkëtueshme është i rëndësishëm për të përcaktuar nëse do të njihen ose jo të ardhurat ose shpenzimet. Si pjesë e procesit të njohjes së të ardhurave, vlerëson nëse do të rrjedhin përfitime ekonomike të lidhura me transaksionin.

3.10. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 është 15%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të ketyre aktive dhe detyrime për qëllime tatimore. Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet. Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.11. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.12. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhur.

3.13. Krahasueshmeria e informacionit kontabel

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese duhet të axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese. Shoqëria e ka filluar aktivitetin nga data e transferimit efektiv të aktiveve dhe detyrimeve nga ndarja e UKT sh.a. me date 31.10.2019, ndaj vlerat krahasuese me date 31.12.2018 janë me vlera zero, në këto pasqyra financiare.

3.14 Njohja e shpenzimeve

Shpenzimet janë flukse dalëse (pakësimet e përfitimeve ekonomike) gjatë periudhës raportuese që rezultojnë në pakësimin e aktiveve apo rritjen e detyrimeve dhe që zvogëlojnë kapitalin e njësisë ekonomike, duke përjashtuar këtu ato që lidhen me shpëmdarjet te pjesëmarrësit e kapitalit. Njohja e shpenzimeve rezulton direkt nga njohja dhe matja e aktiveve dhe detyrimeve. Një njësi ekonomike duhet të njohë

shpenzimet në pasqyrën e performancës financiare kur lind një ulje në përfitimet e ardhshme ekonomike që lidhet me një pakësim të një aktivi ose rritje të një detyrimi, e cila mund të matet me besueshmëri.

3.15 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Rënia në vlerë e llogarive të arkëtueshme.

Shoqëria llogarit zhvlerësimin për llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshmeve të tjera bazuar në humbjet e vlerësuar që rezultojnë nga paaftësia e klientëve për të bërë pagesat e detyrimeve të tyre. Vlerësimi është bazuar në analizën e vjetërsisë të llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën historike të nxjerrjes jashtë librave kontabël, cilësinë e klientit dhe ndryshimet në termat e pagesës së klientit kur vlerësohet saktësia e humbjes nga zhvlerësimi për llogaritë e dyshimta. Kjo përfshin supozimet për sjelljen e ardhshme të klientit dhe mbledhjet e ardhshme të parave. Në qoftë se kushtet financiare të klientit përkeqësohen, rregjistrimet aktuale të llogarive të arkëtueshme ekzistuese mund të jenë më të larta sesa priten dhe mund të kalojnë nivelin e humbjeve nga zhvlerësimi të njohura deri tani. Kompania testoi llogaritë e arkëtueshme të saj nëse ato kanë një rënie në vlerë në përputhje me politikat e brendshme të Kompanisë.

Metoda e Vlerësimit

Meqenëse 95.5% e llogarive të arkëtueshme me vlerë bruto, është transferuar nga UKT sh.a. në UKK sh.a., vlerësimi i kësaj pjese është kryer bazuar në politikën kontabël të aplikuar nga shoqëria transferuese dhe janë paraqitur në vlerat sipas proces verbalit të marrjes në dorëzim në Dhjetor 2019. Llogaritë e Arkëtueshme për efekte të vlerësimit të vlerës së drejtë janë trajtuar si vijon:

Vlerësuar Individualisht

UKK sh.a fillimisht vlerëson nëse ka evidencë të humbjes së vlerës në rang individual dhe që kjo evidencë është materiale në grupin e aktivitetit financiar.

Nëse UKK sh.a identifikon sa më sipër që nuk ka evidencë për humbje vlere atëherë ajo e përfshin aktivin në një klasë të aktiveve financiare me karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit dhe i vlerëson ata kolektivisht për rënien në vlerë. Aktivitetet që janë vlerësuar individualisht për rënien në vlerë dhe për të cilët humbja nga rënia në vlerë është ose vazhdon të njihet nuk janë përfshirë në një vlerësim kolektiv për rënien në vlerë.

Vlerësuar Kolektivisht

Flukset e ardhshme monetare në një grup të aktiveve financiare që janë vlerësuar kolektivisht për rënien në vlerë parashikohen në bazë të eksperiencës së humbjes historike për aktivitetet me karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit me ato në grup.

Në rastet kur UKK Sh.a nuk ka një eksperiencë humbjeje specifike ose ka një eksperiencë të pamjaftueshme, atëherë përdor eksperiencën e shoqërive që operojnë në të njëjtin treg.

Humbjet janë rregulluar në bazë të të dhënave aktuale të vëzhguara për të reflektuar efektet e kushteve aktuale të cilat nuk kanë ndikuar periudhën në të cilën është bazuar eksperiencia e humbjes historike dhe të mënjanojë efektet e kushteve në periudhën historike që nuk ekzistojnë aktualisht.

Vlerësimet e ndryshimeve në flukset e ardhshme monetare të parashikuara reflektojnë dhe janë lidhur në mënyrë konsistente me ndryshimet e të dhënave të lidhura nga periudha në periudhë (të tilla si normat papunësisë, çmimet e pronës, çmimet e produkteve, fuqia paguese ose faktorë të tjerë që janë tregues të humbjeve të shkaktuara në grup dhe magnitudës së tyre).

Metodologjia dhe supozimet e përdorura për flukset e ardhshme të parashikuara janë rishikuar rregullisht për të zvogëluar ndonjë diferencë midis humbjes së parashikuar dhe eksperiencës së humbjes aktuale.

Vlerësimi i Llogarive të Arkëtueshme

Bazuar në specifikën e aktivitetit të Kompanisë si duke marrë në konsideratë politikat e UKT sh.a.për vjeljen e detyrimeve të prapambetura me vështirësi arkëtimi, Shoqëria në varësi të mënyrës së matjes së konsumit të ujit dhe moshës së debisë, ka klasifikuar portofolin e debisë sipas kategorive të abonentëve në 4 klasa Risku. Sipas mënyrës së matjes për çdo kategori abonentit dhe moshës së

debisë, është klasifikuar debia deri më datë 31.12.2019 sipas klasave të riskut të përcaktuara dhe në bazë të kësaj është përlogaritur vlera e zhvlerësimit.

4. Aktivet afatgjata materiale

Bashkelidhur është pasqyra përmbledhëse e Aktiveve Afatgjata materiale me amortizimet perkatese. Të gjitha këto aktive (me përjashtim të blerjes prej 11,000 Lekë) janë transferuar nga UKT-sha, te cilat janë vlerësuar me vlerë të drejtë në Dhjetor 2018. Po kështu kanë kaluar në pronësi të Shoqërisë aktive në proces me vlerë 208,688,021 Leke (Sipas Proces Verbalit U-69/3 Prot 17.12.2019 të firmosur nga Komisioni perkates dhe Administratori ne detyre z.Shpetim Leskaj te cilat jane verifikuar dhe ka perfunduar procesi i marrjes ne dorezim).

Keta aktive afatgjata materiale jane perfshire ne Pasqyren e Pozicionit Financiar te vitit 2019.

Aktive afatgjata materiale më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	Toka	Ndertesa	Rrjeti Ujesjelles	Makineri dhe Pajisje Pune	Aktive ne process	Total
Vlera e drejte me 31.12.2018	0	0	0	0	0	0
Transferuar nga UKT SH.A ne "U.K.K." sh.a. dt. 31.10.2019	9,350,000	3,005,200	119,777,500	854,662	208,688,021	341,675,383
Blerjet gjatë Nentor -Dhjetor 2019	-	-	-	11,000	-	11,000
Pakesime gjate vitit ushtrimor	-	-	-	-	-	-
Vlera e drejte me 31 Dhjetor 2019	9,350,000	3,005,200	119,777,500	865,662	208,688,021	341,686,383
Amortizimi						
Amortizimi me 31.12.2018	-	-	-	-	-	-
Amortizimi i transferuar nga "U.K.K." sh.a. me 31.10.2019	-	(90,554)	(6,279,531)	(159,327)	-	(6,529,412)
Amortizimi I llogaritur Nentor -Dhjetor 2019	-	(18,111)	(1,255,906)	(31,866)	-	(1,305,883)
Amortizimi I akumuluar 31 Dhjetor 2019	-	(108,665)	(7,535,437)	(191,193)	-	(7,835,295)
Vlera neto 31.12.2018	-	-	-	-	-	-
Vlera neto 31.12.2019	9,350,000	2,896,535	112,242,063	674,469	208,688,021	333,851,088

Si rezultat i vlerësimit me vlerë tregu të AAM të transferuara, UKT sh.a. ka transferuar krahas aktiveve edhe rezervën e rivlerësimit që ka rezultuar nga ky proces me vlerë 17,851,570 Lekë, vlerë e cila është paraqitur ne rubriken e kapitalit.

5. Llogari të arkëtueshme

Balanca e llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Klientë të UKB Kamëz pas ndarjes 31.10.2019 Bruto	268,991,924	0
Zhvlërësim i llogarive të arkëtueshme UKB Kamëz	(56,060,560)	0
Faturimet Nentor-Dhjetor 2019	12,526,769	0
Llogari të arkëtueshme neto Kamëz	225,458,133	0

Shoqëria ka kryer faturimet e abonentëve për muajin Nentor-Dhjetor 2019 me vlerë 12,526,769 Leke, ndërsa pjesa tjetër e kërkesave të arkëtueshme me vlerë bruto 268,991,924 Lekë dhe zhvlërësimi përkatës, janë transferuar nga UKT sh.a. Vlera e këtyre kërkesave sipas raportit të ndarjes deri në periudhën para transferimit ishte si vijon:

	UKB Kamëz 31 dhjetor 2017	UKB Kamëz 31 dhjetor 2018	UKB Kamëz 31 tetor 2019
Llogari të arkëtueshme tregtare	157,703,426	187,507,539	212,931,365
Llogarite e arkëtueshme	285,966,252	271,680,984	268,991,924
Zhvlërësim i llogarive të arkëtueshme	-128,262,826	-84,173,445	-56,060,560

Me poshte eshte paraqitur evidenca përmbledhëse e klasifikuar sipas voneses ne pagese:

Kategoria	Llogari të Arketueshm e (Bruto)	Provizioni Deri ne Tetor 2019	Llogari te Arketueshme (Neto)	% Provizion Deri ne Tetor 2019
Buxhetor	2,148,827	22,571	2,126,256	1.05 %
Familjare	17,171,908	2,793,634	14,378,274	16.27%
Familjare pa kanalizim	240,909,718	52,694,421	188,215,297	21.87%
Familjare pa uje	1,958,087	3289	1,954,798	6.47%
Jo-buxhetor	763	49	714	0.17%
Privat	833,973	33,208	800,765	3.98%
Privat pa kanalizime	5,968,649	513,389	5,455,260	8.60%
TOTAL	268,991,924	56,060,560	212,931,364	8.34%

6. Kapitali

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 është në vlerën 289,024,000 Lekë.

	<u>31 dhjetor 2019</u>
Numri aksioneve	289,024
Vlera nominale	1,000
	<u>289,024,000</u>

Aksionet zotërohen 100% Bashkia Kamëz..

Sipas relacionit të venies në zbatim të akteve të ndarjes së shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a me Ujësjetllës Kanalizime Kamëz në vitin 2018 thuhet që është bërë rivlerësimi i aseteve dhe ka

rezultuar 17,851,570 Lekë rezervë nga rivlerësimi dhe (6,976,204) Lekë tatim i shtyrë nga rivlerësimi.

Fitimi i ushtrimit

Shuma prej 5,657,177 Lekë përfaqëson fitimin e ushtrimit përgjatë vitit 2019.

7. Llogari të pagueshme dhe detyrime të përllogaritura

Balanca e llogarive të pagueshme dhe detyrime të përllogaritura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Detyrime për blerje Uji nga UKT	1,449,792	0
Te tjera	11,000	0
Të pagueshme ndaj UKT sh.a. sipas raportit të ndarjes	241,201,439	0
Gjendja më 31 dhjetor	<u>242,662,231</u>	<u>0</u>

Ne zërin Detyrime për blerje Uji nga UKT sh.a. është paraqitur detyrimi i përllogaritur për ujin e shitur për periudhën Nëntor-Dhjetor 2019, pavarësisht faturimit në vitin 2020.

Ne pasqyrën e Pozicionit Financiar të vitit 2019 shoqëria UKK sh.a ka një detyrim nga raporti i ndarjes me UKT sh.a në shumën 241,201,439 Leke. Në lidhje me këtë detyrim është dakordësuar mes paleve në Relacionin e venies në zbatim të akteve të ndarjes që ti propozohet Këshillave Bashkiake respektive që të vendosin që të drejtat dhe detyrimeve të krijuara midis dy shoqërive (UKT sh.a dhe UKK sh.a) si rezultat i veprimtarisë ekonomike nga data 01.01.2017 deri më 31.10.2019 të transferohen pa detyrime të ndërsjellta. Deri në datën e nënshkrimit të këtyre pasqyrave, një akt i tillë nuk është nënshkruar.

8. Detyrime ndaj personelit

Balanca e detyrimeve ndaj personelit më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Paga për t'u paguar	815,078	0
Gjendja më 31 dhjetor	<u>815,078</u>	<u>0</u>

Detyrimet për paga dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, përfaqësojnë detyrime të muajit Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2019. Këto detyrime janë paguar në Janar 2020.

9. Detyrime tatimore

Balanca e detyrimeve tatimore më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2019</u>	<u>31 dhjetor 2018</u>
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	267,603	0
Tatim mbi të ardhurat personale	46,803	0
TVSH për t'u paguar	1,668,461	0
Gjyba Tatimore	270,000	0

Ujësjetllës Kanalizime Kamëz sh.a
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Tatim mbi fitimin	1,045,972	0
Gjendja më 31 dhjetor	3,298,839	0

Per llogaritjen e detyrimeve tatimore Shoqëria ka mbajtur parasysh kerkesat e Ligjit "Per Sigurimet shoqerore dhe shendetesore", "Per TVSH-ne", per "Tatimin mbi te ardhurat" etj, te zbatueshme per aktivitetin e saj.

Këto detyrime janë paguar në Janar 2020 .

10. Të ardhura nga shitjet

Balanca e të ardhura nga shitjet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 që i përket furnizimeve të abonentëve për muajin Nëntor -Dhjetor 2019, pavarësisht datës së faturimit, paraqitet si më poshte:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga konsumatorë familjarë	9,947,962	0
Të ardhura nga subjekte private	824,728	0
Të ardhura nga institucione buxhetore	85,618	0
Gjendja më 31 dhjetor	10,858,308	0

11. Lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme

Balanca e lëndë e parë dhe materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe për 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshte:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime Blerje uji	1,449,792	0
Gjendja më 31 dhjetor	1,449,792	0

Në këtë rubrikë është paraqitur kostoja e ujit të blerë që i përket furnizimeve të abonentëve për muajin Nëntor -Dhjetor 2019, pavarësisht datës së faturës së blerjes në vitin 2020.

12. Shpenzimet e pergjithshme dhe administrative

Balanca e shpenzimeve te pergjitheshme dhe administrative për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshte:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
Penalite Gjoba tatimore	270,000	0
Gjendja më 31 dhjetor	270,000	0

Në këtë rubrikë është paraqitur vlere e gjobave të vendosura nga administrate tatimore, si rezultat i kryerjes se deklarimeve mujore me vonesë, shkaktuar nga problematikat e procesit të ndarjes, të cilat janë sqaruar në pjesën e parë të shënimeve.

13. Shpenzime personeli

Balanca e shpenzimeve te personelit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe për 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshtë:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime për paga	815,078	0
Shpenzime për sigurime shoqërore e Shëndetësore	267,603	0
Tatimi mbi te ardhurat personale	46,803	0
Shpërblime dhe të ngjashme	0	0
Gjendja më 31 dhjetor	<u>1,129,484</u>	<u>0</u>

14. Shpenzime Amortizimi

Shpenzime amortizimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe për periudhën 31 dhjetor 2018 paraqitet si më poshte:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>	<u>Për periudhën 31 dhjetor 2018</u>
Shpenzime amortizimi 2019	1,305,883	0
Gjendja më 31 dhjetor	<u>1,305,883</u>	<u>0</u>

Amortizimi njihet shpenzime me metodën lineare mbi jetën e dobishme të aktivitet për ndërtesat, kompjuterat, furniturat dhe pajisje, rrjeti ujësjetës dhe kanalizimeve dhe mjetet e transportit. Aktivitet e marra me qera amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër midis periudhës së qiramarrjes dhe jetës së tyre të dobishme. Toka nuk amortizohet.

Si shpenzim amortizimi është njohur vlera e amortizimit per muajin Nentor-Dhjetor 2019 pas dakordesimit dhe proces-verbaleve per ndarje me date efektive 31/10/2019.

Vlerësimi i jetës së aktiveve është bërë duke parë nivelin e lartë të konsumimit dhe dëmtimet në asetet e UKK Sh.a. Per kete UKK sh.a ka bere Projekt-Vendimin mbi miratimin e normave te amortizimit te AAM dhe AAJM per vitin 2019 e cila daton me _06/02/2020 Nr.Prot 220/1 dhe ne vendimin e Këshillit Administrativë të UKK sh.a dt.24/02/2020 me 220/2 Prot.

15. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

	<u>Viti 2019</u>	<u>Viti 2018</u>
Fitimi para tatimit	6,703,149	0
<i>Shpenzime te pazbritshme</i>	270,000	0
Gjoha tatimore	270,000	0
<i>Humbjet nga zhvlerësimi</i>	0	0
<i>Te ardhura te patatueshme</i>	0	0
<i>Humbje te mbartura</i>	0	0
Fitimi i tatueshem i ushtrimit	6,973,149	0
Shpenzimi I tatimit mbi fitimin	<u>1,045,972</u>	<u>0</u>

Si kurse shihet nga tabela e mesiperme, shpenzimet e panjohura janë në total 270,000 Lekë (31.12.2018: 0 Leke). Mbi këtë bazë Fitimi i tatueshem i vitit rezulton të jetë 6,973,149 Lekë

(31.12.2018: 0 Leke) dhe shpenzimi për tatim fitimi për vitin 2019 është 1,045,972 Lekë (31.12.2018: 0 leke). Shoqëria rezulton me Tatim fitimi për të paguar shumë prej 1,045,972 Lekë paraqitur në shënimin nr.19 të pasqyrave financiare.

16. Honoraret e audituesve ligjorë

Vlera e honorareve të pagueshme për auditimin e këtyre pasqyrave financiare është dyqind e dyzet mijë Lekë pa tvsh. Kësaj vlere i shtohet tvsh 20% sipas ligjit.

17. Palët e lidhura

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura. Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike nëse kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike. Palë të lidhura konsiderohen edhe drejtuesit e njësisë (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër).

Më poshtë paraqiten balancat ndaj palëve të lidhura:

	Aktive me 31.12.2019	Detyrime me 31.12.2019	Te ardhura viti 2019	Shpenzime viti 2019
Aksionari I vetëm, Bashkia Kamëz	0	0	0	0
Këshilli I administrimit				
Total	0	69,264	0	69,264

	Aktive me 31.12.2018	Detyrime me 31.12.2018	Te ardhura viti 2018	Shpenzime viti 2018
Aksionari I vetëm, Bashkia Kamëz	0	0	0	0
Këshilli I administrimit				
Total	0	0	0	0

18. Ngjarjet pas datës së raportimit

Më 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë deklaroi shpërthimin e koronavirusit (COVID-19) si pandemi. Duke qënë se situata është në zhvillim e sipër dhe ende e pasigurt në datën e publikimit të pasqyrave financiare, Menaxhimi konsideron që është e pamundur të shpaloset një perlogaritje e ndikimit të mundshëm për Shoqërinë. Menaxhimi gjykon se Shoqëria nuk ka efekte të menjehershme të shkaktuara nga pandemia për shkak të llojit të fumizimit që ajo ofron. Menaxhimi konsideron që shpërthimi i COVID-19 vlerësohet si një ngjarje pas datës së bilancit që nuk kërkon rregullime. Nuk ka asnjë ngjarje tjetër të rëndësishme pas datës së publikimit të pasqyrave financiare, që kërkon rregullime ose informacione shpjeguese në pasqyrat financiare.

Pasqyrat financiare janë miratuar nga Këshilli i Administrimit me datë 10 Dhjetor 2020.